



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1142/ 4 prot.

Datë 16 .06.2022

V E N D I M

Nr. 566 /2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.06.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr.REF-27180-04-29-2022 me objekt “Materiale promocionale për aktivitetet e Bashkisë Shkodër”, me fond limit 871,650.00 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1- Shkodër

Ankimues: “Muça” SHPK
Tirane ,Vorë, PICAR, Autostrada Tirane-Durrës, km.13, fshati Picar

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.05.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr.REF-27180-04-29-2022 me objekt “Materiale promocionale për aktivitetet e Bashkisë Shkodër”, me fond limit 871,650.00 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 16.05.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 20.05.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

-“Shkodra Design” SHPK	835,325.00	lekë	skualifikuar
- “Muça” SHPK	854,880.00	lekë	skualifikuar
- “Inpress” SHPK	862,290.00	lekë	kualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Muça” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin:

“-Nuk keni paraqitur sherbime te ngjashme sipas pikes 2.3.1 te DST pasi faturat e paraqitura me Bashkine Lezhe nuk mund te konsiderohen si sherbim I ngjashem pasi ato jane per paisje zyre. Gjithashtu nuk eshte paraqitur kontrata me Bashkine Lezhe dhe vertetimi I realizimit.

-Kontrata me Radio Televizionin Shqiptar nuk eshte e shoqeruar me vertetimin me realizim te sukses te saj.

- Nuk keni në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit sipas te dhenave ne Ekstraktin e QKB tuaj.

- Nuk keni në fushën e veprimtarisë te certifikates ISO 9001-2015 objektin e prokurimit.”

II.4. Në datën 26.05.2022 nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (në vijim SPE) njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 30.05.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër nr. 1142 prot., e operatorit ekonomik “Muça” SHPK duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi duke argumentuar:

“1. Per sa i perket arsyes se pare — mungesa e Furnizimeve te ngjashme, sqarojme:

Ne DT, shenohet: Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit ku të përfshihen postera, banera, çanta kartoni dhe çanta shpine etj., në një vlerë jo më të vogël se 20 “o fondit limit prej 174,330 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ne nenin 40, pika 4 paragrafi 2 te VKM nr 285 per rregullat e prokurimit publik, percaktohet: Autoritetifenti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës oserdhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Ne plotesim te kesaj kerkese, shoqeria jone ka paraqitur:

-Kontraten me drejtorine e RTSH shoqeruar me faturen tatimore sipas ligjit, ne te cilen jane pothuajse te gjithe artikujt promocionale te kerkuar ne kete procedure

-fature tatimore me bashkine Lezhe ne te cilen ka ndonje artikull te ngjashem si psh ADEZIV etj.

Ne keto kushte, pretendimi i KVO -se, per mosparaqitjen e sherbimeve te ngjashme, bie poshte.

2. Persa i perket arsyes se dyte — Nuk keni ne fushen e veprimtarise objektin e prokurimit sipas te dhenave ne ekstraktin e QKB tuaj, sqarojme:

Ne objektin e veprimtarise tone perfshihet edhe objekti i prokurimit, sepse, Produktet promocionale jane mallra industriale te cilet jane te perfshire ne objektin tone:

....Importin dhe eksportin e mallrave industriale..... Ne fushen e ndertimit,ndertime civile dhe industriale

Ne keto kushte, edhe pretendimi i dyte i KVO -se, bie poshte.

3. Per sa i perket arsyes se trete — Nuk keni ne fushen e veprimtarise se certifikates ISO 9001 2015 objektin e prokurimit, sqarojme

Ne DT eshte kerkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose i përditësuar, mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) Pra

Se pari, sic shikohet me lart, AK, nuk ka percaktuar qe certifikata ISO 9001, te perfshije detyrimisht objektin e prokurimit.

Se dyti, megjithate ne fushen e objektit te certifikates tone ISO 9001 2015, perfshihet edhe objekti i prokurimit: import , eksport..... Aktivitete te ndryshme ne investime te prodhimit....

Ne keto kushte, edhe pretendimi i trete i KVO -se,bie poshte.

I kujtojme AK se ne nenin 2 te LPP, thuhet:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik,
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale:
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik,
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë:
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Si perfundim, nepermjet kesaj ankese, bazuar ne nenin 2 te LPP dhe nenin 40 te VKM per RRPP, kerkojme kualifikimin e shoqerise MUÇA shpk, ne kete procedure prokurimi.”

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr.1142/2 datë 31.05.2022 u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Me shkresën nr. 9088 prot., datë 06.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1142/3 prot., datë 08.06.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Muça ” SHPK, në të cilin konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: *“-Nuk keni paraqitur shërbime të ngjashme sipas pikes 2.3.1 të DST pasi faturat e paraqitura me Bashkinë Lezhë nuk mund të konsiderohen si shërbim I ngjashëm pasi ato janë për paisje zyre. Gjithashtu nuk është paraqitur kontrata me Bashkinë Lezhë dhe vertetimi I realizimit.*

-Kontrata me Radio Televizionin Shqiptar nuk është e shoqëruar me vertetimin me realizim të sukses të saj Kontrata me Radio Televizionin Shqiptar nuk është e shoqëruar me vertetimin me realizim të suksesshëm të saj. ” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*1. Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit ku të përfshihen postera, banera, çanta kartoni dhe çanta shpine etj., në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej **174,330 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë)** lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b)vertetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratën me nr. 28/9 prot., datë 02.08.2021 me objekt “ Blerje materiale të ndryshme për Departamentin e Prodhimit në RTSH” të lidhur me Radio Televizionin Shqiptar, bashkëlidhur së cilës ka vendosur faturën elektronike tatimore me nr. 978/2021 datë17.08.2021 për mallrat sipas objektit të kontratës.

- Faturë tatimore shitje me nr. 22077 me blerës Bashkinë Lezhë

- Faturë tatimore shitje me nr. 22078 me blerës Bashkinë Lezhë

-Procesverbal të datës 29.08.2019 i mbajtur nga Komisioni për marrjen në dorëzim të kioskave, Bashkia Lezhë.

III.1.3. Në kthimin e përgjigjes lidhur me këtë pretendim autoriteti kontraktor ka argumentuar:

“1-Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

- Nuk keni paraqitur shërbime të ngjashme sipas pikës 2.3.1 të DST pasi faturat e paraqitura me Bashkinë Lezhë nuk mund të konsiderohen si shërbim i ngjashëm pasi ato janë për paisje zyre.*
- Gjithashtu nuk është paraqitur kontrata me Bashkinë Lezhë dhe vertetimi i realizimit.*
- Kontrata me Radio Televizionin Shqiptar nuk është e shoqëruar me vertetimin me realizim të sukses të saj.*

Pretendimet tuaja për këto pika të skualifikimit të bërë nga KVO janë që ju në plotësimin e këtij kriteri për shërbime të ngjashme të percaktuara në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të DST, keni paraqitur Kontraten me Drejtorinë e RTSH shoqëruar me faturën tatimore dhe një faturë tatimore me Bashkinë Lezhë.

Bazuar në DST e publikuara nga AK. kapaciteti teknik pika 1 germa a, është shprehur si më poshtë:

1. Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit ku të përfshihen postera, banera, çanta kartoni dhe çanta shpine etj., në një vlerë jo më të vogël se 20 “o fondit limit prej 174,330 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve. ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara: b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të Kontratës

Ne plotësimin e kesaj pike ju keni paraqitur dokumentacionin si me poshte:

1-Fature tatimore nr.22077 date 29.08.2019 me Bashkinë Lezhë

2-Fature tatimore nr.22076 date 29.08.2019 me Bashkinë Lezhë

3-Procesverbal i marrjes në dorëzim date 29.08.2019

4-Fature tatimore formati elektronik date 17.08.2021 me RTSH

5-Kontrate furnizimi nr.2879 prot date 02.08.2021 me Drejtorinë e RTSH

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria Muca sh.p.k për plotësimin e kriterit të shërbimeve të ngjashme të percaktuara në DST rezulton se shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike sic janë Bashkia Lezhë dhe Radio Televizioni Shqiptar dhe jo me sektorin privat.

Ne DST e publikuara, Autoriteti Kontraktor është shprehur qarte se për të provuar përvojën e mëparshme me Ente Publike, ofertuesi duhet të paraqesë detyrimisht kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës.

Neni 41 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për të provuar përvojën e mëparshme. autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme. të ngjashme. të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera. afati i përfundimit të kontratës, oserdhe faturave tatimore të shitjes. të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nisur nga ky përcaktim i qarte në DST dhe e VKM Nr.285 datë 19.05.2021, Neni 41 pika 3, ofertuesi nuk mundet kurrësi që ta interpretojë këtë fakt. që për të vërtetuar përvojën e mëparshme me ente publike mund të paraqesë vetëm faturat tatimore të shitjes pa paraqitur kontratën dhe vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës sic është rasti me Bashkinë Lezhë ose vetëm kontratën shoqëruar me faturat tatimore të shitjes pa paraqitur vërtetimin për realizim me sukses të kontratës sic është rasti me RTSH.

Gjithashtu duke analizuar zërat e shërbimit të realizuar me Bashkinë Lezhë vërejmë se ato nuk kanë asnjë ngjashmëri me zërat që kërkon të prokurojë Autoriteti Kontraktor dhe nuk mund të merren në konsideratë.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në lidhje me këtë pikë, arsyet e skualifikimit të bëra nga KVO qëndrojnë dhe janë të mbështetura në DST. Pretendimet tuaja nuk merren parasysh.”

III.1.4. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet

të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit lidhur me *Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit....*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Muça” SHPK lidhur me përmbushjen nga ana e tij të kriterit të përcaktuar në kapacitetin teknik, pika 2.3.1...., lidhur me Shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Muça” SHPK nuk ka përmbushur kriterin e mësipërm. Konkretisht, KPP vëren se nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem, operatori ekonomik ankimues lidhur me dokumentacionin e paraqitur për shërbimet e ngjashme të realizuara me Radio Televizionin Shqiptar (i cili në këtë rast është një ent publik) rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur kontratën e lidhur me këtë subjekt me nr. 28/9 prot., datë 02.08.2021 me objekt “Blerje materiale të ndryshme për Departamentin e Prodhimit në RTSH” si dhe faturën elektronike tatimore me nr. 978/2021 datë 17.08.2021 për mallrat sipas objektit të kontratës, por nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës sipas përcaktimeve të pikës 2.3.1/b të kriterëve të veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik, lidhur me shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit. Gjithashtu edhe me dokumentacionin e paraqitur për shërbimet e ngjashme me Bashkinë Lezhë nga verifikimi në SPE rezulton, se operatori ekonomik ankimues nuk e ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, kriterëve të veçanta të kualifikimit, sepse nuk ka paraqitur kontratën e lidhur me Bashkinë Lezhë (ent publik) si dhe vërtetimin e realizimit me sukses të saj, pasi referuar përmbajtjes së procesverbalit të mbajtur nga Komisioni për marrjen në dorëzim të Kioskave, Bashkia Lezhë citohet *“I mbajtur sot me datë 29.08.2019 në prezencë të përfaqësuesit Muça SHK në bazë të kontratës nr. 6858/3 datë 06.08.2019 “Furnizim vendosje zyra të informimit turistik” dhe komisionit për marrjen në dorëzim të mallit”* çfarë do të thotë se sipas procesverbalit ekziston një kontratë e lidhur në bazë të së cilës janë lëshuar fatura tatimore me blerës Bashkinë Lezhë, kontratë të cilën operatori ekonomik ankimues duhet ta paraqiste në sistemin e prokurimit elektronik bashkë me realizimin me sukses të kontratës për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik lidhur me shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, me qëllim që KPP të mund të shprehej nëse kjo kontratë dhe të gjitha elementet bashkëngjitur saj janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në DST apo jo. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në

dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nuk e ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, kriteret e veçanta të kualifikimit, lidhur me shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit..

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Muça” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit, ato nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik, për arsye se gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vazhdojë të jetë e skualifikuar sipas arsyetimit të mësipërm të KPP-së.

Sa më sipër pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Muça” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr.REF-27180-04-29-2022 me objekt “Materiale promocionale për aktivitetet e Bashkisë Shkodër”, me fond limit 871,650.00 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Muça” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri